

**VENDIM**  
**Nr. 773 , datë 12.12.2022**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 715, DATË 24.11.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIKONSTRUKSIONIT E TË RIPARIMIT TË MJEDISEVE NË BASHKËPRONËSI OSE TË PËRBASHKËTA NË NDËRTERESA (PALLAT), NË BASHKITË TIRANË, DURRËS DHE MIRDITË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Pas pikës 2, të vendimit nr. 715, datë 24.11.2021, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2/1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2022, në masën 458 142 074 (katërqind e pesëdhjetë e tetë milionë e njëqind e dyzet e dy mijë e shtatëdhjetë e katër) lekë, për financimin e rikonstruksionit ose të riparimit të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat), në bashkitë Durrës dhe Mirditë, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Durrës i transferohet fondi, në masën 310 546 268 (treqind e dhjetë milionë e pesëqind e dyzet e gjashtë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë, në formën e transfertës së pakushtëzuar;

b) Bashkisë Mirditë i transferohet fondi, në masën 147 595 806 (njëqind e dyzet e shtatë milionë e pesëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e gjashtë) lekë, në formën e transfertës së pakushtëzuar.”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Durrës dhe Mirditë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Belinda Balluku**